



VENDIMI ESHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOBNAZËNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ / UROSEVAC

18.03.2017

NË EMER TË POPULLIT



**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI PËR KRIME TË**

**RENDA**, sipas gjyqtarit Musa Konxheli – kryetar i trupit gjykues, me anëtarët e trupit gjykues gjyqtarët: Bekim Salihu dhe Ilir bytyqi dhe asistentin Muedin Rexhepi- ne cilesi të procesmbajtësit, duke vendosur sipas aktakuzës se ish Prokurorise Publike te Qarkut ne Prishtinë me nr. PP.NR.698/2003 te dt.07.11.2013 tani te përfaqësuar nga Prokuroria Themelore ne Ferizaj Departamenti i Krimeve te Renda, në çështjen penale kundër të akuzuarit: [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] i cili akuzohej per shkak te veprës penale te vrasjes ne tentativë nga neni 30 al.1 te LPK-se lidhur me nenin 19 te LPJ-se dhe veprës penale nga neni 8.2 qe ndëshkohet sipas nenit 8.6 te Rregullores se UNMIK-ut NR.2001/7 per autorizimin e posedimit te armeve ne Kosovë,pas seancës kryesore publike te mbajtur me dt.19.12.2003,Trupi gjykues i Gjykates se Qarkut ne Prishtinë ka rikualifikuar ashtuqe veprën penale te vrasjes ne tentativë nga neni 30 al.1 te LPK-se e ka rikualifikuar veprën penale te lëndimit te rende trupor nga neni 38 al.1 te LPK-se, ndërsa veprën e dyte e ka vërtetuar si ne aktakuze. Trupi gjykues duke vendosur sipas aktakuzës se larteshenuar,ka caktuar seancën e rigjyimit te kësaj qeshtjeje penale me dt. 28.07.2017 dhe përfundimit te shqyrtimit gjyqesor, dhe seancës se këshillimit e votimit me dt. **28.07.2017**, ne prani te palëve ne procedure(prokurorit te shtetit Rasim Maloku, te pandehurit [REDAKTUAR] dhe mbrojtësit te tij avok. [REDAKTUAR], sjell dhe publikisht shpalli këtë :

**AKTGJYKIM**

**I akuzuari:**

[REDAKTUAR], i biri i [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], i lindur me dt. [REDAKTUAR] ne [REDAKTUAR], me vendbanim ne [REDAKTUAR],ka te kryer shkollën e mesme, i pa pune, i martuar-baba i nje femije, shqiptar, Shtetas i Republikes se Kosoves, i gjendjes se varfër ekonomike, ka qëndruar ne paraburgim nga dt.10.09.2003-19.12.2003

# I

## ËSHTË FAJTOR

### Pika 2:

**Sepse:** Me datë 22.09.2002, rreth orës 19.00h ne [REDAKTUAR] ne [REDAKTUAR] ka mbajtur ne pronësi dhe posedim te paautorizuar armët ne kundërshtim me ligjin e aplikueshëm dhe at enje revole te tipit "Zastava" te tipit 15, te kalibrit 9mm, te cilën e ka përdorur kundër te dëmtuarit Sabit Shehu

- Me qka ka kryer veprën penale nga neni 8.2 e ndëshkueshme sipas nenit 8.6 te Rregullores se UNMIK-ut, nr. 2001/7 per autorizimin e posedimit te armeve ne Kosovë

Prandaj

Gjykata, ne bazë te nenit 5, 38, 41, 48 te LPJ-se dhe nenit 28 al.1 te LPK-se dhe nenit 8.2 qe ndëshkohet sipas nenit 8.6 te Rregullores se UNMIK-ut, Nr.2001/7 per autorizimin e posedimit te armeve ne Kosovë si dhe nenit 346, 347 dhe 351 te LPP-se

## V e r t e t o n

Per veprën penale nga neni 8.5 qe ndëshkohet sipas nenit 8.6 te rregullores se UNMIK-ut, Nr.2001/7 per autorizimin e posedimit te armeve ne Kosovë.

Gjykata ne kuptim te nenit 48 al.1 te LPJ si dhe dispozitave ligjore te neneve te sipërpërmendura te akuzuarin e:

## G J Y K O N

-Per veprën penale nen 2 te dispozitivit i cakton dënim burgimi ne kohëzgjatje prej 3/tre/ muaj, ne te cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim nga dt. 10.09.2003-19.12.2003.

I akuzuari [REDAKTUAR], obligohet qe ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe ate paushallin gjyqësor ne shume prej 50€, ne afat prej 15 ditesh pas plotefuqishmerise se këtij aktgjykimi nen kercnim te përmbarimit me detyrim.

Nga i akuzuari [REDAKTUAR], si mjet i kryerjes se veprës penmale, konfiskohet revolja e tipit "Zastava 15" e kalibrit 9mm.

Çdo kërkesë pronësore juridike duhet të ndiqet përmes gjykatave civile.

## II

Duke u bazuar ne aktgjykimin e ish Gjykates se Qarkut ne Prishtinë P.nr.615/03 dt.19.12.2003 si dhe aktvendimin e Gjykates Supreme te Kosoves AP.nr.436/2004 dt.25.01.2005 me te cilin eshte prishur aktgjykimi i ish Gjykates se Qarkut ne Prishtinë dhe ka mbetur kualifikimi juridik i veprimeve te te akuzuarit si Lendim i rende trupor nga neni 38 al.1 te LPK-se dhe per te cilën veprë penale eshte parashikuar dënimi me burgim nga 6 muaj deri ne 5 vjete, andaj Prokuroria konstaton se eshte bere :

### **PARASHKRIMI i ndjekjes penale**

konform nenit 95 al.4 lidhur me nenin 96 al.6 te LPJ-se, i zbatueshëm, pasi qe kane kaluar mbi 10 vite nga kryerja e veprës penale- pra parashkrimi i ndjekjes penale ka ndodhur me dt.22.09.2012, kurse ne rastin konkret kualifikimi juridik sipas aktakuzës fillestare vrasje e rende ne tentative nga neni 30 al.1 lidhur me nenin 19 al.1 te LPJ-se nuk mund te zbatohet ne rigjykim per shkak te parimit Reformatio In peius, pasi qe prokurori i qeshtjes nuk ka ushtruar ankese kundër aktgjykimit te ish Gjykates se Qarkut ne Prishtinë me te cilin eshte bere ricilesimi juridik i veprës penale.

Shpenzimet e procedurës penale per kete pike te aktakuzës bien ne barrët te mjeteve bugjetore te gjykatës.

Per realizimin e kërkesës pasurore juridike, i dëmtuari udhëzohet ne kontest civil

## Arsy etimi

### 1. Historiku procedural, shqyrtimi gjyqësor dhe deklarimet e palëve

Ish Prokuroria Publike e Qarkut ne Prishtinë me aktakuzën PP.nr.698/03 te dt.07.11.2003 e ka akuzuar te pandehurin [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] per shkak te veprës penale te vrasjes ne tentative nga neni 30 al.1 te LPK-se lidhur me nenin 19 te LPJ-se dhe veprën penale nga neni 8.2 qe ndëshkohet sipas nenit 8.6 te Rregullores se UNMIK-ut 2001/7 per autorizimin e posedimit te armeve ne Kosovë.

Duke vendosur kete qeshtje penalo-juridike ish Gjykata e Qarkut ne Prishtinë me dt.19.12.2003 ka sjell aktgjykimin P.nr.615/03 me te cilin pas ricilesimit te vepres penale te vrasjes ne tentative nga neni 30 al.1 te LPK-se lidhur me nenin 19 te LPJ-se te akuzuarin e ka shpall fajtor per vepren penale te lendimit trupor nga neni 38 al.1 te LPK-se si dhe per vepren penale nga neni 8.5 qe ndeshkohet sipas nenit 8.6 te Rregullores se UNMIK-ut 2001/7 per autorizimin e posedimit te armeve ne Kosove.

Kunder ketij aktgjykimi mbrojtja e te akuzuarit ka parashtruar ankese ne shkallen e dyte me qrast Gjykata Supreme ka aprovuar ankesen e mbrojtjes ashtu qe permes aktvendimit AP.nr.436/2004 dt.25.01.2005 eshte prishur aktgjykimi i ish Gjykates se Qarkut ne Prishtinë dhe ka mbetur kualifikimi juridik i veprimeve te te akuzuarit si Lendim i rende trupor nga neni 38 al.1 te LPK-se .

Gjykata Themelore ne Ferizaj-DKR,ka caktuar seancen e rigjykimit me dt.28.07.2017 ne te cilen séance para leximit te aktakuzes Prokurori i shtetit deklaroi se pas shiqimit te shkresave te lendes dhe te aktgjykimit te ish Gjykates se Qarkut ne Prishtinë P.nr.615/03 dt.19.12.2003 si dhe aktvendimit te Gjykates Supreme te Kosoves AP.nr.436/2004 dt.25.01.2005 me te cilin eshte prishur aktgjykimi i ish Gjykates se Qarkut ne Prishtinë dhe ka mbetur kualifikimi juridik i veprimeve te te akuzuarit si Lendim i rende trupor nga neni 38 al.1 te LPK-se dhe per te cilën vepër penale eshte parashikuar dënimi me burgim nga 6 muaj deri ne 5 vjete, andaj Prokuroria konstaton se eshte bere parashkrimi i ndjekjes penale

konform nenit 95 al.4 lidhur me nenin 96 al.6 te LPJ-se,i zbatueshëm,pasi qe kane kaluar mbi 10 vite nga kryerja e veprës penale-pra parashkrimi i ndjekjes penale ka ndodhur me dt.22.09.2012,kurse ne rastin konkret kualifikimi juridik sipas aktakuzës fillestare vrasje e rende ne tentative nga neni 30 al.1 lidhur me nenin 19 al.1 te LPJ-se nuk mund te zbatohet ne rigjykim per shkak te parimit Reformacio In peius,pasi qe prokurori i qeshtjes nuk ka ushtruar ankese kundër aktgjykimit te ish Gjykates se Qarkut ne Prishtinë me te cilin eshte bere ricilesimi juridik i veprës penale.

Kurse sa i përket veprës penale posedim i paautorizuar i armeve beje ripershkrim te dispozitivit si vijon:

**Sepse:** Me datë 22.09.2002,rreth orës 19.00h ne Lagjen e Re ne Kaqanik ka mbajtur ne pronësi dhe posedim te paautorizuar armët ne kundërshtim me ligjin e aplikueshëm dhe at enje revole te tipit "Zastava" te tipit 15,te kalibrit 9mm, te cilën e ka përdorur kundër te dëmtuarit [REDAKTUAR]. Me qka ka kryer veprën penale nga neni 8.2 e ndëshkueshme sipas nenit 8.6 te Rregullores se UNMIK-ut, nr. 2001/7 per autorizimin e posedimit te armeve ne Kosovë

Pas kësaj gjykata kërkoi nga i pandehuri te deklarohet lidhur me fajsin apo pa faj sine e tij per veprën penale te ripërshkruar nga Prokurori veprën penale nga neni 8.2 e ndëshkueshme sipas nenit 8.6 te Rregullores se UNMIK-ut, nr. 2001/7 per autorizimin e posedimit te armeve ne Kosovë

I pandehuri [REDAKTUAR] pas konsultimit te mjaftueshëm me mbrojtësin avok. [REDAKTUAR] [REDAKTUAR],vullnetarisht deklaroi se e ndien veten fajtor dhe e pranon faj sine ne tersi per veprën penale mbajtja ne pronësi te armeve e ripërshkruar nga ana e prokurorit te shtetit, se eshte penduar per veprimin e tille dhe kërkoi falje si dhe premtoj se veprime te tilla nuk do ti përsëris.

Per pranimin e faj sise se te pandehurit u takorduan edhe prokurori i shtetit dhe mbrojtja,andaj trupi gjykues pranoi pranimin e faj sise se deklaruar nga vete i pandehuri per veprën penale nga neni 8.2 e ndëshkueshme sipas nenit 8.6 te Rregullores se UNMIK-ut, nr. 2001/7 per autorizimin e posedimit te armeve ne Kosovë.

### **Fjala Perfundimtare e Paleve**

Prokurori i shtetit ne fjalën perfundimtare deklaroi:se mbetem ne tersi pranë aktakuzës se ndryshuar ne shqyrtimin kryesor dhe kualifikimit juridik te veprës penale, andaj duke u bazuar edhe ne faktin e pranimi te fajsize nga ana e te akuzuarit i cili pranim mbeshtetet edhe ne provat tjeraqe gjenden ne shkresat e lendes, i propozoi Gjykates qe i njëjti te shpallet fajtor per veprën penale nga neni 8.2 e ndëshkueshme sipas nenit 8.6 te Rregullores se UNMIK-ut 2001/7 per autorizimin e posedimit te armeve ne Kosovë dhe ti shqiptoi nje sanksion penal te parashikuar me ligj.

Gjithashtu propozoi qe te njëjtit ti konfiskohet edhe arma e sekuestruar "Zastava 15", e kalibrit 9mm.

Mbrojtësi i te pandehurit avokati [REDAKTUAR] ne fjalën perfundimtare deklaroi:se me rastin e caktimit te llojit dhe lartësisë se dënimit i propozojmë Gjykates qe ti merr per baze rrethanat lehtësuese qe i përkasin klientit tim-ketu te akuzuarit [REDAKTUAR] si dhe rrethanat objektive e qe ne rastin konkret manifestohen ne ate se i akuzuari [REDAKTUAR] me pare ka qene person i pagjykuar, prej pas vitit 2002 kur ka ndodhur ngjarja kritike asnjëherë asnjëherë nuk ka ardh ne kundërshtim me ligjin. Vetëm vlen te theksohet per gjykatën se ne vitin 2002 [REDAKTUAR] dhe familja etij sipas traditave kane arritur pajtim dhe mardhenjet ndernjerezore midis [REDAKTUAR] te dëmtuarit dhe familjes [REDAKTUAR] janë mardhenje te mira.

I pandehuri [REDAKTUAR] ne fjalën perfundimtare deklaroi se ne tersi pajtohet me deklarimin e mbrojtësit te tij dhe kërkoi nga gjykata qe ti shqiptoi nje sanksion penal sa me te bute.

### **FAKTET E PRANUESHME**

Gjykata gjeti se ne veprimet e te pandehurit [REDAKTUAR] formohen te gjitha elementet e veprës penale nga neni 8.2 e ndëshkueshme sipas nenit 8.6 te Rregullores se UNMIK-ut 2001/7 per autorizimin e posedimit te armeve ne Kosovë, andaj te njëjtin e shpalli fajtor per kete vepër penale dhe i shqiptoi dënim si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

## MATJA E DENIMIT

Gjate shqiptimit të dënimit gjykata ka pas parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me ligj të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethane lehtësuese të akuzuarit [REDAKTUAR] e ka marrë rrethanën se i njëjti ka pranuar fajsinë, se është penduar, se ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, se me parë nuk ka qenë i gjykuar, se është i moshës së re, ndërsa si rrethane rënduese ka marrë për bazë faktin se i njëjti pas kryerjes së veprës penale ka ikur dhe nuk është dorëzuar për shumë muaj të organet kompetente dhe duke i vlerësuar të gjitha këto rrethana të njëjtit ja ka shqiptuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej 3/tre/ muaj duke i llogaritur qëndrimin në paraburgim nga dt.10.09.2003-19.12.2003, duke qenë i bindur se me një dënim të tillë arrihet qëllimi ndëshkuesor i paraparë me ligj.

Vendimi mbi konfiskimin e armës-revoles së markës "Zastava 15" e kalibrit 9mm, është marrë në kuptim të nenit 69 të LPJ-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale dhe paushallin gjyqësor u muar në kuptim të nenit 98 al.1 të LPP-së.

Nga arsyet e lartpërmendura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i krimeve të Rënda

PKR.nr.3/17. më 28.07.2017

Asistenti,  
Muedin Rexhepi

Kryetari i trupit gjykues

Musa Konxheli



**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë përmes Gjykatës Themelore në Ferizaj për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi përmes kësaj gjykate.